

**2023**

**PROSPEKTI**  
**I FONDIT TË PENSIONIT**  
**VULLNETAR**  
**SIGAL PRO**



## **Emërtimi i Fondit:**

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO (në vijim "Fondi")

## **Shoqëria Administruese:**

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA Group Austria" sh.a. (në vijim "Shoqëria Administruese") e regjistruar në regjistrin tregtar me NIPT K61423001P, me seli në adresën: Rruga "Ukraina e Lirë" pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë.

Organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit kryhet ekskluzivisht nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA Group Austria" sh.a

**Asetet e fondit të pensionit vullnetar Sigal Pro janë tërësisht të ndara nga asetet e shoqërisë administruese dhe nga asetet e fondeve të tjera të pensionit vullnetar që administrohen nga Shoqëria Administruese.**

**DATA E PUBLIKIMIT: 20.12.2022**



## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Kemi kënaqësinë që nëpërmjet prospektit të sjellim tek ju informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e Fondit të Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO**.

Fondi i Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO** është licencuar me vendim nr. 251 datë 20.12.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria Administruese e Fondve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA Group Austria" sh.a është licencuar me vendim nr. 50 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e fondeve të pensionit vullnetar dhe me vendim nr. 95, datë 28.04.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", është përgatitur prospekti me qëllim që anëtarët që dëshirojnë të marrin pjesë në Fondin e Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO**, përpara marrjes së vendimit për anëtarësim, të kenë informacionin e nevojshëm.

Shoqëria Administruese nëpërmjet prospektit, do të mundohet t'ju vijë në ndihmë duke ju dhënë informacionin e duhur mbi Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL PRO, kushtet për përfitim pensioni, shtrirjen e rrjetit të saj, Bankën Depozitare me të cilën bashkëpunon, fushat e investimit, informacion mbi zhvillimet financiare dhe legjislative dhe mbi të gjitha për të siguruar një transparencë maksimale në marrëdhëniet me anëtarët.

Gjithashtu, Shoqëria Administruese ka treguar kujdesin e nevojshëm që ky informacion të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto marrëdhënie.

Shoqëria Administruese vë në dispozicion të çdo anëtari apo personi të interesuar prospektin, duke e konsideruar të këshillueshme njohjen me përmbajtjen e tij, përpara se të marrë vendimin për t'u anëtarësuar në Fond, në mënyrë që të krijojë një ide të qartë për funksionimin e Fondeve të Pensionit me Kontribute të Përcaktuara dhe mbajtjes së riskut të investimit dhe të kërkojë në çdo kohë zbatimin e tij.

Duke shpresuar që jemi emri që ju i besoni të ardhmen tuaj,  
Fondi i Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO**

# PËRMBAJTJE

I. PËRKUFIZIME TË TERMAVE .....	5
II. FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SIGAL PRO .....	7
III. FORMA LIGJORE E SHOQËRISË ADMINISTRUESE.....	8
IV. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	9
V. STRUKTURA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	13
VI. KONTRIBUTET E ANËTARËVE TË FONDIT TË PENSIONIT .....	14
Pagesa e kontributeve të anëtarëve në fondin e pensionit .....	14
Llogaritja e Kuotave të Fondit .....	15
VII. POLITIKA E INVESTIMEVE .....	16
Objektivi i politikës së investimeve .....	16
Shpërndarja strategjike .....	16
Investimet e lejuara .....	18
Investimet e palejuara .....	18
Ndryshimet e politikës së investimeve të fondit .....	19
VIII. ADMINISTRIMI I RISKUT .....	20
IX. TATIMI .....	24
Trajtimi fiskal i fondit .....	24
Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët .....	24
Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi .....	25
Trajtimi Fiskal i Kontributeve të Tatimpaguesit individë. ....	25
Trajtimi fiskal i përfitimeve të marra nga anëtari .....	25
X. PAGESA E PËRFITIMEVE .....	26
XI. TËRHEQJA E ASETVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE .....	30
XII. TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE .....	33
XIII. DEPOZITARI .....	34
Roli i depozitarit .....	34
Funksionet e depozitarit .....	35
XIV. AUDITI I JASHTËM .....	35
XV. INFORMIMI I ANËTARËVE MBI VLERËN E ASETVE DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE .....	36
XVI. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARIT ME SHOQËRINË ADMINISTRUESE .....	36

## I. PËRKUFIZIME TË TERMAVE

**“Asete”** - Letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese apo të depozitarit.

**“Autoriteti”** - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

**“Anëtar”** - Personi fizik, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit në bazë të kontratës së tij me shoqërinë administruese, në masën e zotërimit të kuotave.

**“Depozitar”** - Banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit.

**“Diversifikim i portofolit”** - Investimet e asetëve të fondit në instrumenta të ndryshëm, në mënyrë që të zvogëlohet risku nga investimi.

**“Fond pensioni vullnetar”** - Një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit.

**“Fond pensioni profesional”** është fondi i pensionit, për të cilin punëdhënësi ka kontraktuar me shoqërinë administruese, për t’u ofruar punonjësve të vet një plan pensioni profesional.

**“Fitim nga kapitali”** - Të ardhurat nga diferenca e çmimit të asetëve.

**“Këshilli i administrimit”** - Organi i vetëm i shoqërisë administruese me funksion administrimi dhe mbikëqyrjeje.

**“Kontribues”** - Anëtari në një fond pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, i cili paguan kontributet e pensionit në llogarinë e pensionit të anëtarit të fondit të pensionit.

**“Kuotë pensioni”** - Pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e asetëve të fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të asetëve të fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të fondit të pensionit është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të asetëve të këtij fondi pensioni.

**“Kthim nga investimi”** - Rezultati që merret nga investimi i aseteve dhe fitimi i kapitalit.

**“Letra me vlerë”** - Titujt dhe instrumentet financiare derivate.

**“Përfitime”** - Pagesa në para, në formë pensioni të shumave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit.

**“Plan pensioni”** - Kontrata ndërmjet individit dhe shoqërisë administruese për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen individit i cili me pëlqimin e vet bëhet anëtar i fondit të pensionit.

**“Plan pensioni profesional”** - Kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen punëmarrësit i cili me pëlqimin e vet bëhet anëtar i fondit të pensionit.

**“Portofol”** - Tërësia e investimeve të kryera me asetet e fondit.

**“Menaxher i portofolit”** – Personi që është përgjegjës në shoqërinë administruese për administrimin e portofolit.

**“Transferim i aseteve”** - Transferimi i aseteve nga një fond pensioni te një fond tjetër.

**“Shoqëri administruese e fondit të pensionit vullnetar”** (shoqëri administruese) - Një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga autoriteti, për të administruar një ose disa fonde të pensionit.

## II. FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SIGAL PRO

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të tij, në emër dhe në përfitim të të cilëve është hapur një llogari dhe që kanë të drejtë përfitimi në të ardhmen në bazë të kontratës së anëtarësimit që është lidhur.



**Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO veprimtarinë e tij e ka filluar në 20.12.2022, që nënkupton datën e publikimit të prospektit të parë, ku pasqyrohet informacion i vërtetë dhe korrekt për fondin e pensionit, funksionimin e tij dhe të Shoqërisë Administruese.**

**Misioni i Shoqërisë Administruese** konsiston në administrimin e Fondeve të Pensionit Vullnetar , për mbledhjen dhe investimin e kontributeve të anëtarëve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, në përputhje me Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”.

### III. FORMA LIGJORE E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar dhe të aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28.04.2022, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese ka nën administrim:

- Fondin e Pensionit Vullnetar **SIGAL** licencuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Fondin e Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO** licencuar me vendim nr. 251 datë 20.12.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA Group Austria" sh.a. është një shoqëri aksionare me:

Seli: Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë  
Numri Unik i Identifikimit: K61423001P

Data e themelimit: 21.01.2006

Data e regjistrimit: 31.01.2006

Shoqëria Administruese zotëron kapital të regjistruar: 57,028,800 lekë.

Shoqëria Administruese mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" dhe ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria Administruese gjatë punës së saj vepron me ndershmeri, kujdesin e duhur e profesionalizëm, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira.



## IV. PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

### Shoqëria administruese ka dy aksionarë:

Shoqëria e Sigurimeve "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.	51% të aksioneve
Z. Avni PONARI	49% të aksioneve

**Shoqëria e Sigurimeve "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.** është një institucion financiar i krijuar në Shtator 2004 me vendim të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për kryerjen e sigurimeve të jetës.

Kjo kompani ofron një gamë të gjerë produktesh sigurimi për të gjitha klasat e jetës. Aktualisht ka pozicion kryesues në tregun shqiptar për sigurimet e jetës dhe po përforcon pozicionin e saj në treg duke e dominuar atë. "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. ka hartuar dhe zbatuar produkte të reja të sigurimit përmes bankave si dhe ka hedhur në treg produkte të kombinimit të Sigurimit të Jetës me skemat e Kursimit Afatgjatë. Hartimi i këtyre produkteve është realizuar me mbështetjen e veçantë të UNIQA GROUP AUSTRIA dhe eksperiencës së saj në vendet e tjera të rajonit.

**Z. Avni PONARI**, është një nga themeluesit dhe drejtuesit e parë të tregut privat të sigurimeve në Shqipëri

nëpërmjet themelimit të shoqërisë së sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

Nën menaxhimin e Z. Ponari, vetëm pas pak vitesh aktivitet, shoqëria e sigurimeve "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a. arriti të kryesojë tregun shqiptar të sigurimeve duke u renditur si kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri që nga viti 2002 dhe në vazhdim.

Kontributi i Z. Ponari vlerësohet dhe në zhvillimin e biznesit në tërësi, ku vlen të theksohet roli i tij si: anëtar i Bordit Drejtues të Dhomës Amerikane të Tregtisë që nga viti 2002 e në vazhdim, anëtar i Bordit Këshillues të BKT, Kryetar i Bordit Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Siguruesve disa vite radhazi, anëtar i Bordit Drejtues të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Marinës që nga viti 2001 dhe në vazhdim. Aktualisht mban edhe titullin si President dhe Kryetar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

## Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:

## I. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

1. Edvin Hoxhaj, Shoqëria "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

2. Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

## II. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

1. Adrian Totokoçi, Kryetar
2. Abdyl Sarja, Anëtar
3. Edvin Hoxhaj, Anëtar
4. Klement Mersini, Anëtar
5. Elvis Ponari, Anëtar

**Këshilli i Administrimit** ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikat financiare dhe politikat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

**Z. Adrian Totokoçi**, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.

Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

- Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri.
- Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri,
- Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

Z. Adrian Totokoçi nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.



Adrian Totokoçi, Kryetar



Edvin Hoxhaj, Anëtar



Abdyl Sarja, Anëtar



Klement Mersini, Anëtar



Elvis Ponari, Anëtar

**Z. Abdyl Sarja**, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.

Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.

Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006).

Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Albanian Insurance Association. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z. Edvin Hoxhaj**, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti.

Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA (që nga viti 2008); anëtar i Bordit Këshillimor të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, Kosovë (që nga viti 2012) dhe anëtar i Bordit Këshillimor të UNIQA Life a.d. Shkup (që nga viti 2014) Maqedonia e Veriut.

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.



**Z.Klement Mersini** ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.

Aktualisht, Z.Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e riskut, menaxhimin e aseteve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Elvis Ponari** është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group Austria” sh.a.. Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAZ. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të riskut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja.

Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

## V. STRUKTURA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO administrohet nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

Për kryerjen e misionit të saj konform dispozitave ligjore, shoqëria administruese ka krijuar strukturat e saj. Krijimi i strukturës organizative mbështetet në funksionet që ajo ka sipas statutit dhe licencës së marrë si dhe të nevojës për përmbushjen e misionit të saj.

**Struktura Organizative paraqitet sipas një ORGANIGRAME të përshkruar në vijim:**



Administrator i Shoqërisë Administruese është **Z. Elvis Ponari**, i emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe i miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, me afat 3 vjeçar deri më 20/06/2023, me të drejtë rinovimi. Administratori i shoqërisë administruese është person fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese:

- përfaqëson shoqërinë administruese
- organizon dhe menaxhon veprimtarinë e shoqërisë
- përgatit rregulloret e përgjithshme si dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë administruese sipas ligjit në fuqi dhe i propozon për miratim këshillit të administrimit
- vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit dhe kryen aktivitete të ndryshme të përcaktuara në ligj

Për funksionimin e Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO, Shoqëria Administruese ka miratuar dhe stafin zbatues, të përqendruar në Departamente: Departamenti i Përfitimeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Kontributeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Menaxhimit të Portofolit, Departamenti i Administrimit të Riskut, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Shitjeve dhe Departamenti i Juridik, Burime njerëzore & Përputhshmërisë.

Shoqëria administruese ka krijuar edhe strukturat e veta të përbëra nga Degët në Korçë dhe Shkodër.

Gjithashtu, shoqëria administruese përfaqësohet nga degët dhe agjencitë e kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. bazuar në kontratën e shërbimit midis tyre.

## VI. KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIT TË PENSIONIT

Kontributet e anëtarëve përfaqësojnë pagesat në para që kryejnë anëtarët në mënyrë periodike në llogaritë e tyre që kanë në fond.

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO është një fond pensioni me kontribute të përcaktuara.

Skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara janë skema në të cilat kontributet që futen në fond janë të përcaktuara, ndërsa pagesat (përfitimet) janë në funksion të menaxhimit të tyre, ku risqet e skemës i mbajnë anëtarët.

Asetet e fondit të pensionit vullnetar Sigal Pro, janë tërësisht të ndara nga asetet e shoqërisë administruese dhe nga asetet e fondeve të tjera të pensionit vullnetar që administrohen nga Shoqëria Administruese.

Në Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL PRO të drejtën për t'u anëtarësuar e kanë të gjithë personat, pavarësisht nga mosha, vendndodhja dhe punësimi.

Kontributi minimal në Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL PRO është 1,000 lekë.

### Pagesa e kontributeve të anëtarëve në fondin e pensionit

Kontributet për pension vullnetar i paguajnë individët anëtarë të Fondit, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë në emër të tyre në Lekë.

Në rastet kur kontributi paguhet në një monedhë tjetër, shuma e paguar konvertohet në monedhën Lekë me kursin zyrtar të këmbimit valutor, të asaj dite kur bëhet pagesa.

Kontributorët në monedhë të ndryshme nga Lekë mbajnë përsipër riskun e luhatjeve të kursit të këmbimit.

Kontributi për pension mund të paguhet në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Por gjithashtu mund të paguhet edhe si shumë e menjëhershme.

**Individët** paguajnë kontributin për pension në llogarinë bankare të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO në bankën depozitare "BKT", mbi bazë të periudhave të rëna dakord në kontratë.

**Punëdhënësi** mund të paguajë kontributin për pension në llogarinë bankare të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO në bankën depozitare "BKT" në tre mënyra:

a. Nëpërmjet llogarisë bankare, si një shumë të menjëhershme të shoqëruar me listën e punonjësve dhe masën e kontributit mujor për secilin punonjës, kur kontributet përballohen nga punëdhënësi.

b. Nëpërmjet llogarisë bankare, duke dhënë të specifikuar dy shuma të ndara sipas pagesave që kryejnë (punëdhënës dhe punëmarrës) të shoqëruar me listën emërore, kur pjesëmarrja është e përbashkët midis dy palëve.



c. Zbritje automatike nga paga e masës së kontributit të punëmarrësit, sipas marrëveshjes midis palëve (punëdhënës-punëmarrës).

Nëse një anëtar/e përkohësisht ose përfundimisht ndërpret pagesën e kontributit, ai/ajo do të vazhdojë të mbetet anëtar/e në Fondin e Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO** duke ruajtur të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë.

Shoqëria administruese do të informojë çdo anëtar për gjendjen e aseteve të tij në intervale të rregullta kohore.

Ky informacion përfshin llogaritjen e vlerës neto të aseteve që ndodhen në llogarinë individuale të anëtarit, datat e pagesës së kontributeve dhe fitimin nga investimi i tyre, si edhe konvertimin e këtyre aseteve në kuota.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aseteve neto për çdo anëtar. Informimi i klientëve do të bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet faqes së internetit: <https://fondisigal.com.al> dhe një herë në vit me shkresë zyrtare.

Për këtë të gjithë anëtarët e Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO, pajisen që në momentin e nënshkrimit të kontratës me kartën e anëtarësimit ku nëpërmjet numrit të sigurimit dhe fjalëkalimit kanë të drejtë të shohin llogarinë e tyre në çdo moment në faqen zyrtare.

## Llogaritja e Kuotave të Fondit

Çdo anëtar i Fondit të Pensionit Vullnetar **SIGAL PRO** ka një kuotë pensioni, e cila përfaqëson pjesën e pronësisë në fondin e pensionit. Shoqëria administruese konverton në kuotë pensioni, sipas çmimit të kuotës një ditë përpara pagesës së kontributit, kontributet e investuara në fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilin nga asetet e Fondit.

### Shembull i blerjes së një kuote pensioni

- Kontributi: **5,000.00 Lekë**
- Çmimi i kuotës së pensionit në ditën e kontributit : **1,000.00 Lekë**
- Numri i kuotave të anëtarit në Fond: **5,000.00 Lekë / 1,000.00 Lekë = 5 kuota**

Ky transaksion regjistrohet në llogarinë individuale të anëtarit të Fondit.

Nëse pas disa kohësh çmimi i kuotës do të rritet nga **1,000.00 Lekë** në **1,100.00 Lekë**, vlera e aseteve të anëtarit në Fond do të jetë **1,100.00Lekë x 5 kuota = 5,500.00 Lekë**.

## VII. POLITIKA E INVESTIMEVE

### Objektivi i politikës së investimeve

Objektivi i investimit është maksimizimi i kthimit afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Investimi bëhet në përputhje me disa parime:

- Parimi i Sigurisë – Asetet e Fondit investohen në instrumenta me kredibilitet të lartë
- Parimi i Diversifikimit të Portofolit – Asetet e Fondit investohen në instrumenta të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme
- Parimi i ruajtjes së nivelit të mjaftueshëm të likuiditetit – duke siguruar që në strukturën e portofolit të Fondit të ketë instrumenta likuide.

### Shpërndarja strategjike

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

### Shpërndarja strategjike e asetëve për Fondin paraqitet si më poshtë:

Lloji i Aseteve	Shpërndarja strategjike Target
Tituj të Qeverisë Shqiptare	99 %
Mjete Monetare, ekuivalentë të tyre & Depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë	1 %

Për propozimin e politikave të investimit dhe ndjekjen e zbatimit të tyre, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009 për “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, si dhe të rregullores së AMF datë 28.01.2010 “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të Investimit të fondit të pensionit”, Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 120, datë 24.08.2016, është ngritur Komiteti i Investimit me përbërje:

1. **Z. Elvis Ponari**, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese
2. **Z. Klement Mersini**, Drejtor i Departamentit të Financës në Shoqërinë e Sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA.
3. **Z. Blodin Çuçi**, Administrator i Caesar Investment Advisory Services
4. **Z. Naim Hasa**, Ekspert në fushën e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve Private

**Komiteti i Investimit** mbledhet jo më pak se 4 herë në vit, për të hartuar politikat e investimit, shpërndarjen e aseteve si dhe ndryshimet e tyre dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Administrimit. Këto politika mbështeten mbi analiza cilësore dhe sasiore të tregjeve të kapitalit, riskut, si dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit, sipas ligjit dhe rregullores së mësipërme.

Për ndjekjen e investimeve, janë ngritur dy departamente, ku:

**Departamenti i Administrimit të Riskut:**

kryen identifikimin, matjen dhe kontrollin si sasior dhe cilësor të të gjitha llojeve të risqeve që lidhen me fondin dhe aktivitetin e shoqërisë administruese dhe bën menaxhimin e tyre, duke kontrolluar edhe aktivitetin e tregut në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet, në përputhje me riskun ekzistues.



**Departamenti i Menaxhimit të**

**Portofolit:** është përgjegjës për administrimin e aseteve të fondeve të pensionit në përputhje me ligjin, prospektin dhe rregulloret. Ai është përgjegjës për ekzekutimin e politikave të investimit në përputhje me kufijtë ligjorë dhe me vendimet strategjike të Këshillit të Administrimit.





## Investimet e lejuara

Bazuar në kërkesat ligjore dhe rregullatore për investimin e aseteve sipas kërkesave të nenit 63 të ligjit 10197/2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe të nenit 2 të Rregullores së AMF, nr.1/2010 “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit të Fondit të Pensionit”, e ndryshuar, asetet e një Fondi Pensioni mund të investohen vetëm në:

1. Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
2. Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
3. Bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
4. Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
5. Letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody’s ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);
6. Aksione ose kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane)

dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

## Investimet e palejuara

Bazuar në nenin 65 të ligjit 10197/2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, asetet e Fondit të Pensionit nuk mund të investohen në:

- Aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës.
- Asete, që nuk mund të shiten ose transferohen.
- Instrumenta derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga risku i kursit të këmbimit apo nga risqe të ngjashme.
- Asetet fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si antike, punime arti, mjete motorike etj.

- Aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
  1. çdo aksionar i shoqërisë administruese
  2. depozitari i fondit të pensionit
  3. çdo person, palë e lidhur me entitetet e radhitura në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi
- Kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë shoqëria Administruese
- Letra borxhi, të emetuara nga vetë punëdhënësi.

### **Ndryshimet e politikës së investimeve të fondit**

Ndryshimet në politikën e investimeve të fondit bëhen në përputhje me kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" gjithashtu edhe në rregulloren nr.1, të AMF "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit të Fondit të Pensionit" të datës 28.01.2010 Ndryshuar me vendimin e Bordit Nr.120, Datë 24.08.2016.

Të gjitha ndryshimet që bëhen mbi politikën e investimeve aprovohen nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese informon anëtarët e fondit për çdo ndryshim të politikës së investimit të Aseteve të Fondit.

Informimi bëhet nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të Fondit, brenda një muaji nga marrja e vendimit për ndryshimin e Politikës së Investimit.



## VIII. ADMINISTRIMI I RISKUT

Investimi në fond detyrimisht përfshin sipërmarrjen e riskut. Nëpërmjet përcaktimit rigoroz të procedurave të administrimit të riskut dhe sistemit të brendshëm, shoqëria administruese është në gjendje të bëjë identifikimin, matjen si dhe administrimin e riskut, sidomos për sa i përket riskut të investimit, tregut, riskut të likuiditetit, riskut operacional dhe riskut të përputhshmërisë.

**Risku i investimit** është risku më i rëndësishëm që mbajnë anëtarët e fondit me kontribute të përcaktuara. Ky risk është në qendër të vëmendjes së Shoqërisë Administruese, pasi norma e kthimit nga investimi është përcaktuesi kryesor i qëllimit të anëtarësimit në fondin e pensionit. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për të arritur një normë kthimi nga investimi sa më të lartë:

- Nëpërmjet përcaktimit dhe përzgjedhjes sa më të përshtatshme të afateve të investimit të aseteve.
- Duke i kushtuar rëndësi procesit dhe efikasitetit të investimit, me qëllim që të këtë përfitim sa më maksimal fondi i pensioneve dhe anëtarët e tij, duke rritur pritshmërinë e kthimit dhe ulur sa më shumë riskun.
- Duke mbajtur nën kontroll riskun e investimit si dhe duke zbatuar kufijtë sasiore që vendosin aktet normative.

**Risku i tregut** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi vlerën e aseteve të Fondit, për shkak të ndryshimeve të tregut. Llojet e riskut të tregut janë:

- Risku i Normës së interesit - Vlera e aseteve të Fondit ndikohet nga ndryshimi i normave të interesit të instrumentave në të cilat Fondi ka investuar. Risku i normave të interesit lidhet me ndryshimin e tyre në kah të papërshtatshëm duke ndikuar vlerën e aseteve: rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së asetit financiar dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së asetit.
- Risku i Kursit të këmbimit - Fondi nuk është subjekt i riskut të kursit të këmbimit pasi Fondi mbahet në monedhën Lekë dhe investimet bëhen në tregun vendas. Në përgjithësi, nëse fondi do investonte asetet në një monedhë të ndryshme nga monedha e Fondit (Lekë) luhatshmëria e pafavorshme e kursit të këmbimit do të rezultonte në ndryshim të vlerës së aseteve të kuotuar në monedhë të ndryshme nga Lekë.
- Risku i Inflacionit - Risku i inflacionit përfaqëson mundësinë që vlera reale e investimit të rezultojë më e ulët për shkak të rritjes së çmimeve.



Shoqëria administruese do të kryejë një kontroll cilësor dhe sasior të riskut të tregut në mënyrë të vazhdueshme, që të zvogëlojë maksimalisht pasojat negative të tij mbi asetet e Fondit të Pensionit.

**Risku i kredisë** lidhet me aftësinë paguese të emetuesit të instrumentave në të cilat investon Fondi. Vlera e aseteve ndikohet në mënyrë direkte në rast të pamundësisë së emetuesit për të ripaguar kapitalin dhe/ose interesat në kohën e duhur. Ndikimi i përkeqësimit të aftësisë paguese të emetuesit reflektohet në uljen e çmimit të obligacioneve, duke e përcjellë këtë ndikim në ulje të vlerës neto të aseteve të Fondit. Shoqëria Administruese ka adaptuar një administrim të kujdesshëm dhe konservator të aseteve të Fondit bazuar në politikën e investimit. Asetet e Fondit janë të investuara në pjesën më të madhe të tyre në tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të cilët përgjithësisht vlerësohen me nivel risku të ulët.

**Risku i likuiditetit** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi aftësinë e shoqërisë administruese për të përmbushur detyrimet e saj. Shoqëria administruese kontrollon riskun e likuiditetit duke përcaktuar detyrimet dhe procedurat për të disponuar në mënyrë të përhershme sasinë e duhur të aseteve likuide të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të saj. Në bazë të analizave dhe planifikimeve, Fondi ka përzgjedhur një shpërndarje strategjike të aseteve në obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë 99% dhe në mjete monetare dhe ekuivalente të tyre & depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë 1%. Kjo shpërndaje është vendosur duke vlerësuar nevojën e ulët për asete në mjete monetare dhe ekuivalente të tyre pasi flukset hyrëse nga kontributet e anëtarëve janë në bazë mujore ndërkohë flukset dalëse në formën e pagesave të pensioneve konsiderohen afatgjata.



**Risku operacional** i referohet humbjeve që mund të ndodhin si pasojë e gabimeve njerëzore në transaksionet e përditshme, sistemeve jo të përshtatshme të informacionit, dështimit të teknologjisë ose ngjarjeve të paparashikuara. Në mënyrë që të minimizohet risku operacional, shoqëria administruese zhvillon sisteme të përshtatshme kontrolli të brendshëm dhe përcakton saktësisht procedurat dhe rregulloret për të gjithë punonjësit në të gjitha fushat e operacioneve, si dhe në rast eventesh të jashtme.

**Risku i përputhshmërisë** përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë administruese për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave. Shoqëria Administruese kryen rregullisht vlerësimin e aseteve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit, përcakton procedurat e identifikimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe siguron që kapitali të jetë në nivelin minimal të kërkuar në përputhje me dispozitat ligjore. Në një nivel të jashtëm, kontrolli i përputhshmërisë me rregulloret kryhet nga depozitari, por edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ushtron kontroll direkt dhe jo-direkt mbi shoqërinë administruese.

**Risku ligjor** i referohet riskut që rezulton nga ndryshimi i legjislacionit i cili rregullon veprimtarinë e Fondit dhe investimet në Fond. Këto ndryshime mund të reflektohen në mënyrën e trajtimit të skemës aktuale të pensioneve lidhur me trajtimin tatimor të përfitimeve, apo në moshën e përfitimit të pensionit. Interpretimet e ndryshme të ligjeve nga autoritetet tatimore dhe gjykatat nuk mund të përjashtohen.



**Risku ndryshimit të tatimit për pensionet vullnetare** përfaqësohet nga ndryshimet e ardhshme në ligjet tatimore për pensionet vullnetare. Bazuar në dispozitat ligjore, anëtarët përfitojnë lehtësira tatimore që zbatohen në fazën e depozitimit të kontributeve dhe janë subjekt tatimi në fazën e përfitimit të pensionit, me normën e tatimit në fuqi në atë periudhë. Në këtë aspekt duhet mbajtur në konsideratë që norma e tatimit për pensionet mund të ndryshojë.

**Risku politik** lidhet me faktin që ndryshime apo ngjarje të rëndësishme politike kanë një ndikim material në mjedisin ekonomik të vendit. Ndryshime të tilla mund të çojnë në vështirësi pague të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të cilat pasqyrohen në uljen e vlerës së obligacioneve dhe për pasojë në vlerën neto të aseteve të Fondit.

Për administrimin e risqeve ligjore dhe politike, Shoqëria Administruese identifikon burimet e riskut, analizon dhe vlerëson në bazë të vazhdueshme impaktin e çdo ndryshimi në mjedisin ligjor dhe politik të vendit.

**Risku i agjencisë** është i lidhur me probabilitetin e ngjarjeve që përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve apo përdorimin e autoritetit në përfitim individual kundrejt përfitimit të Fondit. Shoqëria Administruese e Fondit ka implementuar mekanizma kontraktuale dhe të kontrollit për mirëfunksionimin e Shoqërisë Administruese dhe të Fondit, duke siguruar integritetin në të gjitha proceset në përputhje me ligjet, rregullat dhe mbrojtjen e aseteve të Fondit. Një rol kryesor në proceset e kontrollit ka Banka Depozitare e cila kontrollon transaksionet e anëtarëve të Fondit dhe procesin e investimeve.

**Risku i reputacionit** përfaqëson potencialin për një dëmtim të imazhit si rrjedhojë e perceptimit negativ nga grupet e interesit/publiku për Fondin lidhur me veprime ose mosveprime të Shoqërisë Administruese dhe punonjësve të saj, ngjarje të cilat perceptohen si të papërshtatshme dhe jo-konsistente me vlerat e Fondit. Shoqëria Administruese ka ndërtuar modelin e biznesit të bazuar në besimin e publikut dhe ka krijuar standarde të qëndrueshme për identifikimin dhe vlerësimin e ngjarjeve që mund ta dëmtojnë atë, duke u kujdesur për zbatimin e rregullave dhe sigurimin e transparencës me anëtarët e Fondit.

### **Masat që do të merren për Administrimin e Riskut**

Për administrimin dhe mbajtjen nën kontroll të riskut, shoqëria administruese ka marrë masat e mëposhtme:

- Ngritur strukturat e menaxhimit të riskut dhe rregulloret e funksionimit të menaxhimit të riskut në shoqërinë administruese.
- Të identifikojë shkeljet e limiteve për tregtimin e instrumenteve financiare.
- Të sigurojë buxhetin e nevojshëm për burimet e administrimit të risqeve.
- Të minimizojë efektet negative të tregtimit të parregullt të instrumenteve financiare.
- Të promovojë praktika më të mira të administrimit të riskut.
- Të rishikojë vazhdimisht performancën me bazë risku dhe të përditësojë strategjitë.
- Të promovojë një kulturë të administrimit të riskut, ku kuptimi dhe administrimi i riskut është përgjegjësi e të gjithë punonjësve të shoqërisë administruese, të cilët duhet të veprojnë në përputhje me rregulloret.
- Të sigurojë që të gjithë punonjësit të kuptojnë dhe të përvetësojnë njohuritë bazë të menaxhimit të riskut.
- Të krijojë besim tek anëtarët e fondit në lidhje me administrimin sa më të mirë të fondit në përputhje me rregullat, ligjet dhe duke u bazuar në praktikat më të mira.

## IX. TATIMI

### Trajtimi fiskal i fondit

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat ose taksës mbi vlerën e shtuar (TVSH).

### Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët

Në zbatim të neneve 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, anëtari i fondit ka këto lehtësira fiskale:

- Kontributi i bërë nga çdo anëtar në Fond zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi.
- Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e Fondit, nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin dhe as për shoqërinë administruese.
- Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të Fondit, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit.
- Sipas moshave, në rast se anëtari i Fondit është nën 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 200 000 lekë dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.



-Në rast se anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250 000 lekë dhe 25 % të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.

-Blerja e kuotave të një fondi pensioni është shërbim financiar dhe për rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja.

-Shërbimet e ofruara nga depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe për rrjedhojë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Mbështetur në dispozitat ligjore, Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL PRO ju ofron anëtarëve të tij:

a. Pension Pleqërie të Parakohshëm, 5 vjet para se të mbushë moshën për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”

b. Pension Pleqërie kur mbush moshën për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”.

c. Pension Invaliditeti kur bëhet i paaftë për punë, gjatë kohës së anëtarësimit në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet konform legjislacionit në fuqi.

### **Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi**

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

### **Trajtimi Fiskal i Kontributeve të Tatimpaguesit individë**

Në zbatim të nenit 13/3, të ligjit nr.10 343, datë 28.10.2010 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” (Ndryshuar), tatimpaguesit individë, rezident në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Shqipërisë që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, ju njihen shpenzime të zbritshme edhe kontributet vullnetare të pensioneve, sipas përcaktimeve të mësipërme në ligjin për fondet e pensionit vullnetar.

### **Trajtimi fiskal i përfitimeve të marra nga anëtari**

Çdo pagesë e marrë nga anëtari i fondit të pensionit kur mbush moshën ligjore për përfitim, tatohet me tatimin mbi të ardhurat personale.

Tatimi, që shoqëron tërheqjen e parakohshme, është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes.

## X. PAGESA E PËRFITIMEVE

Për të krijuar një ide se si kohëzgjatja e investimit në fond, madhësia e kontributeve që duhet të depozitohet anëtari në fond si dhe faktorë të tjerë ndikojnë për të përfituar një pension të përshtatshëm më poshtë jepen disa variante të pagesave të kontributeve dhe përfitimeve të përafërta të pensionit me qëllim që anëtari të kuptojë mënyrën e funksionimit të kësaj skeme pensioni.

Shembull 1			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>10,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	8,357,264
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	3,600,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>55,000</b>
Kontributet + Interesat	8,357,264	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	4,842,736
Interesi i fituar gjatë investimit	4,757,264	Interesi i përfituar në total	9,600,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

Shembull 2			
Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>15,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	10,446,884
Norma mesatare e interesit ndër vite	6%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6%
Numri i viteve të investimit	25	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Shumë e menjëhershme	-	Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	4,500,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>75,000</b>
Kontributet + Interesat	10,446,884	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	7,553,116
Interesi i fituar gjatë investimit	5,946,884	Interesi i përfituar në total	13,500,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

**Shembull 3**

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>12,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	5,572,213
Norma mesatare e interesit ndër vite	6%	Norma mesatare e interesit ndër vite	6%
Numri i viteve të investimit	20	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme		Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	2,880,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>47,000</b>
Kontributet + Interesat	5,572,213	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	2,887,787
Interesi i fituar gjatë investimit	2,692,213	Interesi i përfituar në total	5,580,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

**Shembull 4**

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
<b>Kontributet Mujore (lekë)</b>	<b>3,000</b>	Fondet në dispozicion për pension	11,955,553
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	40	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	15
Shumë e menjëhershme	1,000,000	Numri i kësteve në vit	12
Totali i kontributeve	2,440,000	<b>Shuma e pensionit mujor</b>	<b>95,000</b>
Kontributet + Interesat	11,955,553	Interesi i përfituar gjatë kohëzgjatjes së Pensionit	5,144,447
Interesi i fituar gjatë investimit	9,515,553	Interesi i përfituar në total	14,660,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

**Shënim:**

*Përlllogaritjet e mësipërme janë ilustrative duke marrë për bazë vlera të përafërta investimi, por në çdo rast nuk përbëjnë garanci apo premtim për shumën apo normën e kthimit nga investimi.*

Norma e kthimit nga investimi i aseteve të fondit të pensionit është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut. Përlllogaritjet e mësipërme janë të certifikuar nga Z. Arben ÇAVOLLI, aktuar i miratuar edhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, drejtor i departamentit të aktuaristikës të Shoqërisë së Sigurimit "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a.

## Disa opsione për të investuar në Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL PRO

### 1. Pagesa mujore kontributesh dhe përfitim i menjëhershëm

Ky opsion ofron pagesa të përmuajshme të kontributeve dhe përfitime të menjëhershme të aseteve. Anëtarit i lind e drejta të përfitojë pension në varësi të zgjedhjes së tij: në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe.

Kontributi mujor (Lekë)	Pas 15 vitesh		Pas 20 vitesh		Pas 25 vitesh		Pas 30 vitesh	
	Përfitim i menjëhershëm (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Përfitim i menjëhershëm (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Përfitim i menjëhershëm (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Përfitim i menjëhershëm (Lekë)	Fitimi (Lekë)
10,000	2,684,000	884,000	4,127,000	1,727,000	5,979,000	2,979,000	8,357,000	5,357,000
15,000	4,026,000	1,326,000	6,191,000	2,591,000	8,969,000	4,469,000	12,535,000	8,035,000
20,000	5,368,000	1,768,000	8,254,000	3,454,000	11,959,000	5,959,000	16,714,000	10,714,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### 2. Pagesa të menjëhershme dhe pension mujor sipas viteve

Ky opsion ofron pagesë të menjëhershme të kontributeve të cilat investohen për një periudhë të caktuar dhe anëtari në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe, përfiton pension mujor. Periudha në të cilën investohen asetet është e barabartë me periudhën e përfitimit të pensionit mujor.

Kontribut i menjëhershëm (Lekë)	Pension mujor për 10 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 15 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 20 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)
500,000	5,300	136,000	3,970	214,600	3,300	292,000
1,000,000	10,600	272,000	8,000	440,000	6,600	584,000
3,000,000	31,900	828,000	23,800	1,284,000	19,800	1,752,000
4,000,000	42,000	1,040,000	31,000	1,580,000	26,500	2,360,000
5,000,000	53,000	1,360,000	39,000	2,020,000	33,000	2,920,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

### 3. Pagesë të menjëhershme dhe përfitim i menjëhershëm

Në këtë opsion anëtari depoziton një shumë të caktuar dhe zgjedh ta tërheqë menjëherë në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe.



Kontribut i menjëhershëm (Lekë)	Përfitime të menjëhershme pas 10 vitesh investimi (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Përfitime të menjëhershme pas 15 vitesh investimi (Lekë)	Fitimi (Lekë)
500,000	823,000	323,000	1,100,000	600,000
1,000,000	1,640,000	640,000	2,100,000	1,100,000
2,000,000	3,300,000	1,300,000	4,200,000	2,200,000
5,000,000	82,000,000	77,000,000	10,560,000	5,560,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

#### 4. Paga të menjëhershme dhe përfitim mujor sipas viteve

Në këtë opsjon anëtari i cili është në moshën e pensionit shtetëror ose 5 vite para kësaj moshe, depoziton një shumë të menjëhershme dhe zgjedh të përfitojë një pension mujor, ndërkohë që asetet e mbetura në llogari vazhdojnë të investohen.

Kontribut i menjëhershëm (Lekë)	Pension mujor për 10 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 15 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)	Pension mujor për 20 vite (Lekë)	Fitimi (Lekë)
500,000	8,700	544,000	8,400	1,012,000	8,900	1,636,000
1,000,000	17,500	1,100,000	16,500	1,970,000	18,000	3,320,000
2,000,000	35,000	2,200,000	33,000	3,940,000	36,000	6,640,000
5,000,000	87,000	5,440,000	83,000	9,940,000	89,000	16,360,000

Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.

#### Shënim:

*Përlllogaritjet e mësipërme janë ilustrative duke marrë për bazë vlera të përafërta investimi, por në çdo rast nuk përbëjnë garanci apo premtim për shumën apo normën e kthimit nga investimi.*

## XI. TËRHEQJA E ASETEVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE

Anëtari i Fondit është i lirë të zgjedhë mënyrën e tërheqjes së aseteve nga llogaria e tij personale në fondin e pensionit:

- a) në mënyrë të menjëhershme, duke tërhequr të gjithë vlerën neto të aseteve në llogarinë e anëtarit
- b) në mënyrë periodike si pension, duke përcaktuar pagesën mujore dhe periudhën e tërheqjes së saj
- c) me përdorimin e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës;
- d) me kombinimin e mënyrave të cituara në pikat a, b, dhe c më sipër.

Anëtari i fondit të pensionit, pas plotësimit të kushteve për pension, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet.

Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të anëtarit, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës standard, së bashku me dokumentacionin ligjor.

Anëtari i Fondit të Pensionit pas plotësimit të kushteve, mund t'i tërheqë asetet neto të llogarisë së tij të pensionit në formën e pagesave periodike, si pension mujor.

Në rastin e pagesës periodike të aseteve të akumuluar, midis anëtarit të Fondit dhe shoqërisë administruese do të nënshkruhet një kontratë e re mbi pagesat periodike.

Asetet e anëtarit deri në mbarimin e tyre do të rinvestohen. Anëtari i Fondit, në mënyrë të pavarur, përcakton shumën e pagesave periodike, të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij.

Anëtarët mund të kërkojnë pagesa periodike me periodicitet jo më të shkurtër se një mujor.

Shoqëria administruese e fondit të pensionit detyrohet të njoftojë anëtarin 3-mujor para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit.

## Tërheqja e parakohshme

Nëse anëtari i Fondit kërkon të tërheqë asetet e akumuluar në llogarinë e tij individuale, përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj, do të konsiderohet tërheqje e parakohshme.

Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitete, që llogariten në raport me kohën e përmbushur nga anëtari nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme.

**Tarifa e Tërheqjes së Parakohshme** – Tërheqja e parakohshme, krahas pagesës së tatimit e cila është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes, shoqërohet dhe me penalitete.

Për tërheqjet e parakohshme të pensionit, anëtarët e fondit të pensioneve do të paguajnë penalitete si më poshtë:

- 5 % të aseteve të tërhequra pas 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 10 % të aseteve të tërhequra pas 10 deri 20 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 15 % të aseteve të tërhequra pas 5 deri 10 vjet nga dita e pagesës së kontributit të parë
- 20 % të aseteve të tërhequra deri 5 vjet nga dita e pagesës së parë të kontributeve

## Mënyra e Pagesës së Pensionit

Pensioni paguhet në lekë në llogarinë bankare të anëtarit, sipas marrëveshjes së lidhur për këtë qëllim nga shoqëria administruese me anëtarin në momentin e caktimit të përfitimit.

Kur pagesa e pensionit kërkohet të paguhet në një monedhë tjetër, shuma e paguar konvertohet me kursin zyrtar të këmbimit valutor, të asaj dite kur bëhet pagesa.

Kontributorët në monedhë të ndryshme nga lekë mbajnë përsipër riskun e luhatjeve të kursit të këmbimit.

Shoqëria Administruese për çdo rast të vonuar në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike, detyrohet t'i paguajë anëtarit të fondit të pensionit shumën shtesë, në formë interesi.

Shuma e interesit të pagueshëm tek anëtari i fondit për çdo pagesë të vonuar llogaritet proporcionalisht:

- (a) Për çdo ditë vonesë, duke filluar që nga dita e parë kur lind detyrimi për kryerjen e pagesës, deri në ditën kur kryhet pagesa.
- (b) Mbi shumën e pagesës së vonuar.

Në llogaritjen e interesit do të përdoret norma e interesit TRIBID, 12 mujore, e kërkuar për pranimin e depozitave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 5%.

Në rastet e pamundësisë për të tërhequr personalisht mjetet në llogarinë e tij, për çdo arsye të dokumentuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga shoqëria administruese, anëtari i fondit të pensionit ka të drejtë të autorizojë personin e përcaktuar për të tërhequr të gjitha mjetet financiare të grumbulluara në llogarinë e tij, sipas kërkesës për caktim përfitim/transferim asetesh dhe dokumentacionit shoqërues sipas ligjeve në fuqi.

### **Humbja e jetës së anëtarit**

Nëse anëtari humb jetën përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta, asetet e mbetura në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve sipas aktit të trashëgimisë dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi trashëgiminë.

### **Transferimi i llogarisë së anëtarit**

Anëtari ka të drejtë në çdo kohë të transferojë asetet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një shoqëri tjetër administrimi.

Nëse një anëtar në një fond, vendos që të transferojë asetet e veta në një fond të ri pensioni, duhet të njoftojë paraprakisht për vendimin e tij shoqërinë administruese të fondit ekzistues, se kontrata me këtë shoqëri administruese do të përfundojë dhe se asetet e tij duhet të transferohen në fondin e ri të pensionit.

Transferimi i aseteve në Fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas dhjetë ditësh pune, pasi shoqëria administruese e Fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga anëtari. Ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë së re administruese do të nënshkruhet një kontratë e re. Transferimi i llogarisë nuk mund të kryhet nëse detyrimet e anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer tërësisht.

Transferimi i aseteve në një fond të ri i cili administrohet nga një shoqëri tjetër administruese, shoqërohet me tarifë transferimi e cila paraqitet në seksionin XII të këtij Prospekti.



## XII. TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Për administrimin e Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO, Shoqëria Administruese, do të ketë tarifën e mëposhtme:

**1. Për Koston e Administrimit** – Tarifa e koston së administrimit të Fondit do të jetë në nivelin deri 2.2% në vit të vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.

Tarifa e administrimit do të llogaritet në fund të çdo dite dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës ose në ditën e parë të muajit pasardhës.

### Shembull

Llogaritja e tarifës së koston së administrimit do jetë mbi bazën e vlerës neto të aseteve të fondeve nën administrim për muajin përkatës.

- Tarifa vjetore për shoqërinë administruese është 2.2%
- Kontributi mujor 5,000.00 lekë
- Fitimi mujor nga investimi është:  $7\% \text{ (bruto)} / 12 \times 5,000.00 = 29.17$  lekë
- Asetet e anëtarit (kontributi + fitimin) në fund të muajit do të jenë 5,029.17 lekë
- Tarifa e administrimit të muajit do të jetë:  $2.2\% / 12 \times 5,029.17 = 9.22$  lekë.
- Vlera neto e aseteve të anëtarit në fund të muajit do të jetë  $5,029.17 - 9.22 = 5,019.95$  lekë
- Tarifa mujore për koston e administrimit do të jetë 9.22 lekë

**2. Tarifa e Transferimit** – Tarifa e transferimit, kur anëtari i transferon asetet e tij nga një fond pensioni në një fond tjetër pensioni të menaxhuar nga një shoqëri e re administruese, do të jetë në nivelin 0.5% të shumës së transferuar.

Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë asetet e tij, nga një fond pensioni në një fond tjetër pensioni, të menaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese, nuk do të zbatohet tarifë transferimi.

**3. Tarifa të tjera** – Përveç tarifave të përmendura më lart, anëtari i Fondit të Pensionit është i detyruar që të kompensojë shoqërinë administruese për të gjitha shërbimet shtesë të ofruara sipas kërkesës së anëtarit (si për shembull: shpenzime të ndryshme bankare, shpenzimet postare, etj.)

## XIII. DEPOZITARI

Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", asetet e fondit të pensioneve, përfshirë mjetet monetare mbahen tek një depozitar i vetëm, i cili duhet të jetë një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtarinë e Depozitarit.

Shoqëria Administruese, ka lidhur marrëveshje kujdestarie me bankën "Banka Kombëtare Tregtare" (BKT) me seli në adresën: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri. Kjo bankë, në përputhje me ligjin nr.10 197 të datës 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar" do të ofrojë shërbimet e kujdestarisë, të depozitimit dhe të besimit për asetet e fondit.

Depozitari BKT është një entitet ligjor i rregulluar, licencuar dhe mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me nr. 6/1998, datë 11.01.1999.

Mban dhe licencën si Depozitar i Fondit të Pensioneve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendimin nr. 4 datë 21.12.2015.

Llogaria e derdhjeve të kontributeve të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PRO, pranë BKT është:

**IBAN : AL2120511007000869BLFIRLALLQ**

### Roli i depozitarit

1. Depozitari është përgjegjës për ruajtjen e aseteve të fondit të pensionit.
2. Depozitari i mban asetet, veprimet dhe dokumentet e fondit, të ndara nga njëra-tjetra dhe nga mjetet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.



## Funksionet e depozitarit

1. Depozitari llogarit vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit dhe informon shoqërinë administruese, jo më rrallë se një herë në 30 ditë, për vlerën neto të aseteve të anëtarëve të fondit të pensionit.
2. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të fondit të pensionit nga shoqëria administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës së fondit të pensionit dhe të legjislacionit në fuqi. Depozitari nuk duhet të kryejë asnjë veprim të kërkuar nga shoqëria administruese, që bie në kundërshtim me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.
3. Depozitari siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të pensionit, t'i kthehet fondit të pensioneve çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara.
4. Depozitari siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit të shpërndahen në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.

Depozitari duhet të informojë menjëherë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo çështje, që gjykon se cilësohet si një veprim ose mosveprim, që mund të përbëjë shkelje të legjislacionit, të kontratës së fondit të pensionit ose të kërcënojë interesin e anëtarëve.

## XIV. AUDITI I JASHTËM

Shoqëria Administruese llogaritë e veta dhe të Fondit që administron, krahas strukturave të kontrollit të brendshëm dhe administrimit të riskut, i auditon çdo vit dhe në afate të ndërmjetme edhe nga Auditues të Jashtëm.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA" sh.a., ka auditues të jashtëm kompaninë audituese Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. e cila është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. ka zyrën qendrore në adresën Rr. Ibrahim Rugova , Sky Tower, Kati 9/1, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar me nr. fiskal L92014010J, me nr. Regjistri 701 në regjistrin e audituesve ligjorë.

Tel: 04 229 0700

E-mail: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: <https://www.pwc.com/al>

### Personat përgjegjës:

Laureta Këlliçi (Administratore)

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

## XV. INFORMIMI I ANËTARËVE MBI VLERËN E ASETEVE DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

Shoqëria Administruese siguron një transparencë të vazhdueshme për anëtarët e fondit duke i informuar për situatën e aseteve të tyre nëpërmjet:

- a) sistemit duke mundësuar kontroll 24 orë në llogaritë individuale të anëtarëve në faqen e internetit [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al)
- b) njoftimit me shkrim një herë në vit për gjendjen e aseteve neto të tyre.

Shoqëria administruese është përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aseteve neto për çdo anëtar të Fondit.

Shoqëria administruese publikon vlerën neto të aseteve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese.

## XVI. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARIT ME SHOQËRINË ADMINISTRUESE

Marrëveshja e anëtarësisë në Fondin e Pensionit përfundon në rastet kur:

- Anëtari fiton të drejtën për të tërhequr dhe përdorur asetet e akumuluar. Në këtë rast, marrëveshja e anëtarësisë do të përfundojë dhe do të arrihet një marrëveshje e re, e bazuar mbi mënyrën e tërheqjeve të aseteve të akumuluar.
- Llogaria e anëtarit transferohet në një Fond tjetër.
- Anëtari ndërron jetë përpara moshës së pensionit.

Nëse anëtari i Fondit ndalon së paguari kontributet, ai vazhdon të mbetet anëtar në Fond, deri në tërheqjen përfundimtare të aseteve të tij.



**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA  
ALBANIA**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME / HEADQUARTER**  
**BLV. "ZOGU I", NR. 1, TIRANA - ALBANIA**  
**TEL. (+355) 4 2233 308, FAX. (+355) 4 2250 220,**  
**E-MAIL: INFO@SIGAL.COM.AL, WWW.SIGAL.COM.AL**

**TIRANË 1**  
**BLV. "ZOGU I", PLL. DIPLOMATËVE, NR. 57**  
TEL. (+355) 2233 308  
**TIRANË 2**  
**RR. "UKRAINA E LIRË", PAS KULLAVE BINJAKE**  
TEL. (+355) 44 511 666  
**TIRANË 3**  
**BLV. "GJERGJ FISHTA", KOMPLEKTI DELIJORGJI**  
TEL. (+355) 44 330 171  
**TIRANË 4**  
**RR. "ELBASANIT", PËRBALLË ISH- 7XHUXHAT**  
TEL. (355) 68 40 81979  
**TIRANË 6**  
**RR. "SOTIR CACI", PRANË FRESKUT**  
TEL. (355) 67 201 2309  
**TIRANË 7**  
**RR. "TEODOR KEKO", PRANË ASTIR**  
TEL. (355) 69 409 6371  
**BERAT**  
**L. "28 NËNTORI"**  
TEL. (+355) 32 234605  
**DIBËR**  
**L. " NAZMI RUSHITI ", PESHKOPI**  
TEL. (+355) 218 25155  
**DURRËS 1**  
**L. NR. 3, RR. "SKËNDERBEJ",**  
**QENDRA E BIZNESIT MONUN**  
TEL. (+355) 522 31047  
**DURRËS 2**  
**RR. "TREGTARE", NR.42, BLV. KRYESOR**  
TEL. (+355) 69 365 7105  
**ELBASAN 1**  
**L. "28 NËNTORI", RR. "11 NËNTORI",**  
**PLL.109/1, KATI 2**  
TEL. (+355) 54 244446  
**ELBASAN 2**  
**L. " KONGRESI ELBASANIT", RR. "BAKI**  
**KONGOLI", SHATËRVANI KRYESOR**  
TEL: (+355) 69 40 96 303  
**FIER 1**  
**L. "1 MAJI", RR. JANI BAKALLI,**  
**TEK KUPOLA CENTER**  
TEL. (+355) 69 209 3814  
**FIER 2**  
**L. "APOLLONIA", BLV. "JAKOV XOXA",**  
**PLL. 1, SHK. 4**  
TEL. (+355) 342 23035  
**FUSHË KRUIJË**  
**PALLATI HARK, QENDËR**  
TEL. (+355) 563 22869  
**GJIROKASTËR 1**  
**L. "PUNËTORE", RR."NACIONALE"**  
TEL. (+355) 842 67080

**KAVAJË**  
**L. NR. 1, SALLBEG**  
TEL. (+355) 552 42562  
**KORÇË**  
**BLV. "REPUBLIKA", PRANË**  
**KINEMA MILENIUM**  
TEL. (+355) 822 50433  
**KUKËS**  
**L. NR. 5**  
TEL. (+355) 242 24532  
**LAÇ**  
**QENDËR**  
TEL. (+355) 536 4578  
**LEZHË**  
**L. BESËLIDHJA, SHESHI BESËLIDHJA**  
TEL. 0215 24656  
**LUSHNJE**  
**L. "LONI DHAMO"**  
TEL. (+355) 352 21532  
**MAMURRAS**  
**QENDËR**  
TEL. (+355) 69 20 25 829  
**MAT**  
**L. "PARTIZANI", BURREL**  
TEL. (+355) 217 22746  
**PËRMET**  
**SHËTITORJA "ODHISE PASKALI"**  
TEL. (+355) 813 23293  
**POGRADEC**  
**L. NR 2 RR., "RINIA", PALLATI 80**  
TEL. (+355) 832 26792  
**PUKË**  
**RR. "IMER PUKA", BLLOKU NR. 1**  
TEL. (+355) 212 22880  
**RRËSHEN**  
**SHESHI "ABAT DOÇI", MIRDITË**  
TEL. (+355) 69 20 74 581  
**SARANDË**  
**L. NR. 1, RR. "FLAMURIT", NR. 19**  
TEL. (+355) 852 25045  
**SHKODËR 1**  
**L. "VOJO KUSHI", RR. "ÇLIRIMI",**  
**PRANË TEATRIT "MIGJENI", KATI II**  
TEL (+355) 222 44429  
**SHKODËR 2**  
**L. "V.SHANTO", RR."ÇAJUPI" , PLL.**  
**FISHTA 2**  
TEL. (+355) 222 49680  
**TROPOJË**  
**QENDËR, BAJRAM CURRI**  
TEL. (+355) 213 23101  
**VLORË**  
**L. PAVARËSIA, QENDRA TREGTARE**  
**RIVIERA**  
TEL. (+355) 332 23121





Life **UNIQA GROUP AUSTRIA**

SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONEVE

**FOND PENSIONI**

*E ardhmja jomë së bashku*



Adresa, Rr. "Ukraina e  
Lirë", Tiranë, Shqipëri



Tel : +355 44 511 666  
Fax : +355 42 250 220



E-mail: [info@fondisigal.com.al](mailto:info@fondisigal.com.al)  
[www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al)